

Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

lidhur me vizitën në Qendrën e Shëndetit Mendor në Podujevë

**Për: Z. Arben Vitia, ministër në detyrë
Ministria e Shëndetësisë**

**Kopje: Z. Elvir Azizi, drejtor i përgjithshëm
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës**

**Znj. Adelina Stublla, drejtoreshë
Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - Komuna e Podujevës**

**Z. Dren Sejdiu, u.d. i drejtorit
Qendra e Shëndetit Mendor në Prishtinë**

**Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra për Qeverisje të Mirë - Zyra e Kryeministrit**

Prishtinë, më 5 gusht 2025

Qëllimi i raportit

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejshëm: MKP), më 20 mars dhe më 2 prill 2025 vizitoi Qendrën e Shëndetit Mendor (në tekstin e mëtejshëm: QShM) në Podujevë.

Qëllimi i vizitës në QShM-në në Podujevë ishte ta vlerësojë dhe ta analizojë ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor në komunitet si dhe respektimin e të drejtave të personave me probleme të shëndetit mendor.

Kjo analizë synon të hedhë dritë mbi aspektet kyçe të disponueshmërisë, qasjes dhe cilësisë së këtyre shërbimeve, në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me legjislacionin në fuqi dhe me standardet ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës. Ky raport ofron një pasqyrë të kushteve aktuale në Qendrën e Shëndetit Mendor në Podujevë dhe ka për qëllim t'i identifikojë sfidat ekzistuese dhe të propozojë rekomandime konkrete për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të shëndetit mendor për personat me probleme të shëndetit mendor duke siguruar një qasje të barabartë e pa diskriminim për të gjithë.

Shërbimi Profesional i Shëndetit Mendor në Republikën e Kosovës është themeluar, organizuar bazuar në rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (në tekstin e mëtejshëm: OBSH), sipas përvojave më të mira të shteteve evropiane.

Shërbimi është themeluar dhe ndërtuar duke u udhëhequr nga parimi i shërbimeve me bazë në komunitet, parimi i regjionalizimit të shërbimeve, ndërtimit të infrastrukturës për ofrim të shërbimeve në komunitet. Kjo formë e shërbimit është ndërtuar për të arritur qasje sa më të lehtë dhe më të afërt të klientët dhe familjarët e tyre duke fuqizuar personin me çrregullime të shëndetit mendor dhe familjarët e tyre, duke ndjekur parimet dhe praktikën e de-institucionalizimit, respektimit të dinjitetit, autonomisë dhe integritetit të personave me çrregullime të shëndetit mendor, pa përjashtim race, gjinie, etnie, përkatësie fetare si dhe për luftimin e paragjykimëve dhe stigmës.

Baza Ligjore

1. Avokati i Popullit, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta) dhe sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit¹ (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Avokatin e Popullit), pos të tjerash, i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- *“Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike (neni 132, paragrafi 1, i Kushtetutës);*
- *Avokati i Popullit mund të japë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore (neni 135, paragrafi 3, i Kushtetutës);*
- *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, i Ligjit për Avokatin e Popullit);*

¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.16/, 26 qershor 2015¹, Prishtinë: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10922>.

- të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, i Ligjit për Avokatin e Popullit);
- t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, i Ligjit për Avokatin e Popullit)."

Korniza ligjore dhe analiza e çështjes

2. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara² siguron të drejtat dhe liritë e të gjithë personave me aftësi të kufizuara, me fokus barazinë, respektimin e dinjitetit dhe mosdiskriminimin në sfera të ndryshme, përfshirë edukimin, shëndetin dhe shërbimet sociale.

Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri, njësoj sikurse pjesa tjetër e shoqërisë.

3. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara siguron qasje në shërbime shëndetësore cilësore të personave me aftësi të kufizuar, pa asnjë diskriminim. Neni 16, paragrafi 4, thekson: *"Shtetet Palë të marrin të gjitha masat e duhura për të nxitur rikuperimin fizik, kognitiv dhe psikologjik të personave me aftësi të kufizuar, si edhe rehabilitimin dhe riintegrimin e atyre personave të cilët janë viktimë të çdo lloji forme shfrytëzimi, dhune apo abuzimi, përmes ofrimit të shërbimeve mbrojtëse. Rikuperimi dhe riintegrimi do të ndodhin në një mjedis që nxit shëndetin, mirëqënien sociale, vetërespektin, dinjitetin dhe autonominë e personit dhe merr parasysh nevojat specifike gjinore dhe moshore."*
4. Ligji nr. 05/L-025 për Shëndet Mendor³ (në tekstin e mëtejshëm: LShM) ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen me të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore. Ky ligj në nenin 5 ka përcaktuar parimet themelore të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor mbi të cilat mbështeten të gjitha dispozitat e tij: *"1.1. Trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime mendore, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor; 1.2. Ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat me çrregullim mendor në një ambient sa më pak shtrëngues, kryesisht në nivel komunitar, për të shmangur në maksimum zhvendosjen nga mjedisi familjar e për të lehtësuar integrimin dhe rehabilitimin social; 1.3. Krijimi i lehtësirave përmes programeve dhe projekteve të cilat implementohen nga organet kompetente për këta persona dhe familjet e tyre me qëllim të përfshirjes së tyre në jetën shoqërore; 1.4. Ofrimi i kujdesit për personat me çrregullime mendore nga ekipe multidisciplinare që i përgjigjen në mënyrë komplekse nevojave mjekësore, psikologjike, sociale dhe të rehabilitimit; 1.5. Ushtrimi i të drejtave të personave me çrregullime mendore në përputhje me aktet*

² Kombet e Bashkuara, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, miratuar më 13 dhjetor 2006, hyri në fuqi më 3 maj 2008, në dispozicion në: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-rights-persons-disabilities>.

³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.33/23, 2015, Prishtinë: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11229>.

ndërkombëtare të aplikuara në Kosovë.”

5. Neni 10 i Ligjit për Shëndetin Mendor përcakton shërbimet shëndetësore, përmes së cilave ofrohet kujdesi për shëndet mendor, siç janë: kujdesi shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor. Neni 15 i Ligjit për Shëndetin Mendor thekson se shërbimet e shëndetit mendor të kujdesit dytësor dhe tretësor shëndetësor menaxhohen në bazë të Statutit të ShSKUK-së.⁴
6. Në shërbimet e shëndetit mendor të nivelit dytësor bëjnë pjesë Qendrat e Shëndetit Mendor dhe Shtëpitë Integruese në Bashkësi, ku gjithsej janë tetë (8) Qendra të Shëndetit Mendor (QSHM), me nëntë (9) Shtëpi për Integrim në Bashkësi (ShIB), që ofrojnë shërbime të shëndetit mendor në zonat regjionale, si: Prishtinë, Podujevë, Mitrovicë, Prizren, Pejë, Ferizaj, Gjakovë, Gjilan.
7. Shërbimi Profesional i Shëndetit Mendor të Prishtinës përfshin njësitë organizative-funksionale në komunat: Prishtinë, Podujevë, Fushë Kosovë, Obiliq, Drenas, Lipjan dhe Graçanicë. Pra, në kuadër të QShM-së në Prishtinë është edhe QShM-ja në Podujevë dhe dy Shtëpi Integruese në Bashkësi në Bresje dhe në Drenas, me gjithsej 40 persona në staf për këto 4 institucione.
8. Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, përkatësisht Neni 19 - Kujdesi dytësor shëndetësor, thekson se organizimi dhe veprimtaria e institucioneve shëndetësore të kujdesit dytësor përcaktohet me akte nënligjore të nxjerra nga Ministria.
9. Udhëzimi Administrativ nr.07/2009 (në Shëndetësi) për shërbimet profesionale të shëndetit mendor në Republikën e Kosovës, i cili e ka rregulluar administrimin e shërbimeve të shëndetit mendor të nivelit dytësor, vendosjen e rezidentëve në Shtëpitë Integruese në Bashkësi dhe shumë çështje të tjera lidhur me këtë kategori të personave, është shfuqizuar me Vendim Nr. 02/50 të QRK-së, të datës 23.12.2021. Pavarësisht shfuqizimit të këtij udhëzimi, QShM-ja në Gjakovë, si dhe të tjera në rajone të ndryshme, vazhdojnë t'i ndjekin praktikat e vendosura nga ky udhëzim.
10. Neni 30 i Ligjit për Shëndetin Mendor, lidhur me monitorimin e jashtëm të shërbimit të shëndetit mendor thekson: *“Avokati i Popullit, nëpërmjet mekanizmave të tij, vëzhgon rregullisht me anë të inspektimeve periodike, respektimin e të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave me çrregullime mendore në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor.”*

Qendra e Shëndetit Mendor në Podujevë

11. Qendrat e Shëndetit Mendor (QShM) duhet të ofrojnë shërbime, si: qëndrim ditor për personat me probleme mendore, me të cilët duhet të zhvillojnë psikoterapi individuale dhe grupe, aktivitete psiko-sociale, aktivitete rehabilituese dhe të punës, aktivitete të edukimit shëndetësor, zbatim të terapisë antipsikotike, të japin terapi me medikamente falas, shërbime psikiatrike dhe psikologjike; duhet të ofrojnë edhe konsultime telefonike brenda në Qendër. Gjithashtu ekipet shumë disiplinore mobile të Qendrës duhet të dalin në terren me qëllim të mbështetjes psiko-sociale, dhënies së terapisë me rregull, njëkohësisht të ofrojnë edhe mbështetje për familjen e pacientëve. Të gjitha këto aktivitete të QShM-ve janë paraparë në nenin 8 të UA nr.07/2009 (në Shëndetësi) për

⁴ Shih, Statuti (QRK) nr. 01/2023 i Shërbimit Spitalorë dhe Klinik Universitar të Kosovës
<https://shskuk.rks-gov.net/SHSKUK/ShskukStatus>

shërbimet profesionale të shëndetit mendor në Republikën e Kosovës⁵ si dhe në ueb-faqen e ShSKUK-së.⁶

12. Gjatë vizitës në QShM-në e Podujevës kuptuam se mbi një vit Komuna e Podujevës e ka zhvendosur Qendrën e Shëndetit Mendor nga objekti ku ka qenë dhe përkohësisht e kanë vendosur në objektin ku janë trajtuar rastet me COVID-19. Sipas informatave që mori ekipi i MKP-së, ShSKUK-ja dhe Komuna e Podujevës kanë bërë një marrëveshje mirëkuptimi me shkrim që QShM-ja në Podujevë të vendoset në objektin e emergjencës dhe aty të krijohen kushtet e përshtatshme për ofrim të shërbimeve dhe qëndrim ditor të personave me probleme mendore. MKP-ja konstaton se nuk është bërë asnjë lëvizje nga ana e ShSKUK-së dhe as e Komunës së Podujevës bazuar në atë marrëveshje dhe QShM-ja e Prishtinës, e cila e menaxhon edhe QShM-në e Podujevës, nuk ka marrë asnjë veprim lidhur me këtë çështje.

Kushtet dhe Trajtimi i rasteve në QShM-në në Podujevë

13. Gjatë vizitës u vërejt objekti i papërshtatshëm për stafin, nuk kishin hapësira të mjaftueshme, e kishin në dispozicion vetëm një hapësirë ku qëndron kryeinfermierja, dosjet e pacientëve dhe barnat si dhe një hapësirë e vogël për psikiatrin. MKP-ja vërejt se në korridor e kanë improvizuar një hapësirë për dhënien e terapisë ampulare/injeksion për pacientë dhe në atë korridor qëndron edhe stafi i QShM-së. Nuk kishin vend për zhvillim të asnjë aktiviteti ditor në Qendër dhe në çdo hapësirë të objektit kishte tavolina, ormanë, karrige të demoluara, pra ishte e mbushur me gjërat e panevojshme dhe jofunksionale. MKP-ja konstatoi se objekti ku është vendosur stafi i QShM-së nuk i plotëson as kushtet minimale për stafin dhe për trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor. Në mungesë të kushteve minimale për punë, mbi një vit nuk është realizuar asnjë aktivitet brenda në Qendër, përveç vizitave në terren. Gjithashtu MKP-ja konstaton se në këtë situatë (dhënia e terapisë në korridor) rrezikohet shëndeti edhe konfidencialiteti i trajtimit të rasteve.
14. Stafi i rregullt në QShM-në në Podujevë janë 3 infermierë dhe 1 kryeinfermier, 1 pastrues. Psikiatri që nga fillimi ka qenë me kontratë të rregullt në QShM-në në Podujevë, por tani është prezent dy herë në javë në Podujevë dhe tri herë në javë në QShM-në në Prishtinë, ndërsa psikologu dhe punëtori social nga QShM-ja në Prishtinë vjen në QShM në Podujevë, varësisht nga kërkesat e rasteve.
15. Sipas protokollit të regjistrimit të rasteve, rreth 500 dosje ishin të evidentuara, 390 prej tyre janë raste aktive, që kanë nevojë për shërbime të shëndetit mendor, rreth 55 raste janë me vendim të gjykatës, që e kanë masën e detyrueshme të trajtimit psikiatrik në liri. MKP-ja e vlerëson që rastet me vendim të gjykatave evidentohen në protokoll të veçantë. MKP-ja inkurajon QShM-në në Prishtinë që ta organizojë punën më mirë rreth shërbimit të psikologut dhe të punëtorit social, të cilët duhet ta kenë një orar të rregullt të prezencës së tyre në QShM-në në Podujevë, në mënyrë që t'ju mundësohet qytetarëve të Komunës së Podujevës qasja më e lehtë në këto shërbime.

Konstatimet

16. QShM-ja në Podujevë nuk ka kushte minimale për ofrim të shërbimeve për personat me

⁵ I cili vendim është shfuqizuar me Vendim të QRK, Nr. 02/50 të datës 23.12.2021

⁶ <https://shskuk.rks-gov.net/UnitsCompositeSHSKUK/SHSKUKUnits/qendratprofesionaletshendetitmendor>

probleme të shëndetit mendor, kushtet nuk janë të përshtatshme si për personelin, ashtu edhe për persona që marrin këshillime apo medikamente.

17. Për shkak të kushteve të papërshtatshme qëndrimi ditor dhe trajtimi psiko-social nuk realizohen, si dhe rrezikohet konfidencialiteti i shërbimeve. Stafi është munduar të paktën ta organizojë punën në terren për ta mundësuar trajtimin psikiatrik të rregullt dhe për t'i furnizuar me barna pacientët.

18. Nuk është bërë asnjë lëvizje nga ana e ShSKUK-së dhe as e Komunës së Podujevës bazuar në marrëveshjen e tyre lidhur me zhvendosjen e QShM-së në Podujevë në një objekt të përshtatshëm si dhe QShM-ja në Prishtinë, e cila e menaxhon edhe Qendrën në Podujevë, nuk ka marrë asnjë veprim lidhur me këtë çështje.

19. QShM-ja në Podujevë është e furnizuar mjaftueshëm me barna dhe me mjete higjienike.


Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, i

REKOMANDON

Ministrisë së Shëndetësisë:

- Të monitorohet zbatimi i politikave për shëndet mendor, si dhe të sigurohet se shërbimet që ofrohen respektojnë plotësisht dinjitetin dhe të drejtat e personave me probleme mendore.
- Të zhvendoset QShM-ja e Podujevës në një objekt të përshtatshëm sipas marrëveshjes së mirëkuptimit me shkrim mes ShSKUK-së dhe Komunës së Podujevës.
- T'u mundësohet qëndrimi ditor personave me probleme mendore të Komunës së Podujevës dhe të krijohen kushtet adekuate për ofrimin e shërbimeve në mënyrë konfidenciale.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.") dhe në pajtim me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë."), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.


Me nderime,
Naim Qelaj
Avokat i Popullit